



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

Shpejtim Ndrecaj
Pronar
Radio Vala 2000
R076
Therandë

Vendimi LIC: 2009/13
Ref: 0906/0918/CIMC/II

VENDIM

Lidhur me kërkesën për bartjen të pronësisë së Radio Vala 2000, tek N.SH.E. "Matiqeva Comerc" me pronar z. Bashkim Ndrecaj

Faktet

1. Parashtruesi i kërkesës është, z. Shpejtim Ndrecaj pronari i Radio Vala 2000, subjekt transmetues që operon në Therandë i cili ka pranuar licencën e modifikuar nga Komisioneri i Përkohshëm për Media më 27 maj 2005.
2. Më 28 prill 2008, pronari aktual i Radio Vala 2000 z. Shpejtim Ndrecaj ka paraqitur një kërkesë në zyrën e KPM-së për bartjen në tërësi të pronësisë së licencës në emër të N.SH.E. "Matiqeva Comerc" me pronar z. Bashkim Ndrecaj që është vëllai i pronarit aktual.
3. Arsyeja kryesore e kërkesës për ndryshim të pronësisë është kalimi në aktivitet politik të z. Shpejtim Ndrecaj.
4. Kandidati i propozuar për menaxhimin e Radio Vala 2000, z. Bashkim Ndrecaj ka deklaruar se, përveç ndryshimit të pronësisë nuk do të ketë ndryshim në strukturën e programit apo çfarëdo ndryshimi që nuk është në përputhje me Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së Radio Vala 2000.

5. Më 30 maj 2005, Komisioneri i Përkohshëm për Media ka lëshuar rregulloren mbi Kualifikimet për Marrjen e Licencës për Transmetim (Rregullorja 2005/01) në përgatitje të lëshimit të licencave të korigjuara për të gjitha subjektet transmetuese. Në të njëjtën kohë, Komisioneri i Përkohshëm për Media ka themeluar procedurat për ndryshim të licencës duke kërkuar që të gjitha ndryshimet e tilla të bazohen në një Vendim zyrtar i cili tregon se ndryshimet e tilla janë në interes të publikut.
6. Kandidati i propozuar për pronar të Radio Vala 2000 ka përmbyllur të gjitha kualifikimet dhe procedurat e KPM-së për ndryshim të pronësisë dhe është në pajtueshmëri të plotë me rregulloren 2005/01 të KPM-së.
5. Neni 29.4 i Ligjit të Komisionit të Pavarur për Media dhe Transmetim thekson se: *“Rregullat, kodet dhe procedurat e përcaktuara nga Komisioneri i Përkohshëm për media mbesin në fuqi derisa të ndryshohen, të zëvendësohen apo të anulohen nga Komisioni i përkohshëm për media në pajtim me këtë ligj”.*

Arsyetimi

7. Në bazë të Ligjit Nr. 02/L-15 është themeluar Komision i Pavarur për Media dhe Transmetim i cili është autoriteti i vetëm në territorin e Kosovës për rregullimin e Spektrit të Frekuencave të Transmetimit, për lëshimin e licencave dhe mbledhjen e taksave për licencë transmetimi.
8. Neni 11.1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“për të ushtruar veprimtarin e transmetimit në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon Komisioni i Pavarur për Media”.*
9. Neni 11.4 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“licencat nuk mundë të shfrytëzohen dhe bartën pa autorizim dhe pa aprovim paraprakë me shkrim nga KPM”.*
10. Neni 5.2 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“çdo ndryshim në pronësi që kap më shumë se 10% të aksioneve të interesave ose ato që ndikojnë shumë në kontrollin e të Licencuarit do të kërkojnë paraprakisht autorizim me shkrim nga ana e KPM-së”.*
11. Neni 5.4 i Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së ka siguruar që: *“KPM-ja do të lejojë transferimin e licencës vetëm kur ajo sigurohet që individit ose organizata të cilët propozohen që t’u transferohet licenca plotësojnë standardet e KPM-së për t’u dhënë një licencë”.*
12. Prandaj, në pajtim me nenin 5.4 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, Këshilli i KPM-së konkludon se personit të cilit propozohet t’i

transferohet licenca, i përmbush standardet e kualifikimit për licencë të KPM-së.

13. Arsyetimin për bartje të pronësisë nga ana e parashtruesit të kërkesës, KPM e pranon si të mjaftueshëm dhe në shërbim të interesit publik për të aprovuar kërkesën për bartje të pronësisë.

Vendim

14. Këshilli i KPM-së konkludon se ndryshimi i pronësisë së Radio Vala 2000 nuk do të ndikojë në ndryshimin e formatit të programit dhe zonës së mbulimit.
15. Këshilli i KPM-së konkludon se kandidati për pronarë të ri të Radio Vala 2000 ka njohuri profesionale në menaxhimin e radiostacionit duke marrë parasysh se edhe ashtu ka qenë i përfshirë në strukturat menaxhuese të Radio Vala 2000.
16. Prandaj, Këshilli i KPM-së merr vendim që pronësia e Radio Vala 2000 të bartet tek N.SH.E. "Matiqeva Comerc" me pronarë z. Bashkim Ndrecaj dhe licenca e Radio Vala 2000 të ndryshohet.

Lëshimi i Vendimit

15. Këshilli i KPM-së e lëshon këtë vendim


Argjentina Grazhdani
Kryesuese e Këshillit të KPM-së

15/06/2009
datë

Vërtetim

Më këtë vërtetohet se Këshilli i KPM-së ka marrë këtë vendim në pajtueshmëri me rregulloret dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë, dhe në pajtueshmëri me rregullat e procedurës së KPM-së.


Naife Selimaj Krasniqi
Shefe Ekzekutive



15/06/2009
datë